

VIZITË STUDIMORE E ZNJ. IRENE NOVOTNY, MENAXHERE PROGRAMI PRANË AGJENCISË AUSTRIAKE PËR ZHVILLIM, PRANË QSHNJP ELBASAN.



Vizitë studimore pranë QSHNJP Elbasan midis përfaqësuesit të UNDP Albania, z. Francisco Roquette, përfaqësuesve të ADA, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe z. Kreshnik Ajazi, kryetar i Prokurorisë së Elbasanit, institucion në të cilin është e vendosur Qendra për Shërbimin e Ndihmës Juridike Parësore Elbasan.

TAKIME INFORMUESE NË KAMËZ DHE VORË MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS NË BASHKITË E VOGLA.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, zhvilloi sot takime informuese në Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Vorë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas. Fokusi i këtyre takimeve ishte krijimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet DNJF dhe bashkive të vogla, për të siguruar akses të barabartë në drejtësi për çdo qytetar.



TRAJNIM PËR 4 ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE TË CILAT PËRFITOJNË FINANCIM NGA BUXHETI I SHTETIT.



Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me përfaqësues të organizatave jo fitimprurëse, të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit, për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore.



U FIRMOS MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MES DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM.

Marrëveshja e firmosur mes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim konsiston në vendosjen e bashkëpunimit sa i përket shërbimit të ndihmës juridike falas, me qëllim marrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël me fokus mbrojtjen e të drejtave në punë.



NISIN PRAKTIKAT 3 MUJORE PRANË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS.



Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas mirëpriti praktikantët e rinj për një eksperiencë 3 mujore të vlefshme, ku do të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre ligjore dhe të kontribuojnë në garantimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët.



QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 02.04.2025 organizuan aktivitetin informues mbi Ligjin Nr.111.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit.

QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 08.04.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, zhvilloi një aktivitet Street Law me fokus ndërgjegjësimin e këtij komuniteti mbi ndihmën juridike falas.




QSHNJP Përmet u vendos në fokus të një kronike nga RTSH Gjirokastra. Gjatë kësaj kronike u fol mbi rëndësinë e shërbimit ligjor falas, kategoritë që e përfitojnë atë dhe rastet e trajtuara nga QSHNJP Përmet.

QSHNJP Përmet në datën 29.04.2025 organizoi një aktivitet informues me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarëve lidhur me të drejtën për të përfutur ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti. Aktiviteti u fokusua edhe te ndërmjetësimi si një zgjidhje alternative e konflikteve.



QSHNJP Fier mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Roskovec me rastin e 8 Prillit – Dita Ndërkombëtare e Romëve, ku prezantoi shërbimet e saj dhe promovoi aksesin e barabartë në ndihmë juridike.

QSHNJP Fier mori pjesë në tryezën konsultuese të organizuar nga IRCA dhe Bashkia Fier me aktorë lokalë, në kuadër të 8 Prillit – Ditës Ndërkombëtare të Romëve, ku u diskutua rëndësia e përfshirjes dhe aksesit të barabartë të komunitetit rom në punësim, arsim dhe sipërmarrje.



QSHNJP Fier në datën 10.04.2025 zhvilloi një aktivitet informues në Qendrën Komunitare PAK Roskovec, ku prezantoi shërbimet ligjore falas dhe diskutoi problematika me prindër dhe përfaqësues institucionalë.

QSHNJP Fier në datën 11.04.2025 zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Frakull, në bashkëpunim me KMD, ku u prezantuan shërbimet ligjore falas dhe u trajtuan problematika të ngritura nga qytetarët.



QSHNJP Fier në datën 25.04.2025 Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Fier mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Qendra Vatra mbi rehabilitimin e autorëve të dhunës dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, në kuadër të projektit “Përfundimi i dhunës ndaj grave në Shqipëri”.



QSHNJP Durrës në datën 11.04.2025 zhvilloi një takim në kuadër të 8 Prillit - Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom me qytetarë, pjesë të këtij komuniteti, pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale “Nishtulla”.



QSHNJP Vlorë në datën 08.04.2025 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Vlorë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, ku u diskutua mbi nevojat dhe arritjet në shërbim të komunitetit rom, si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për rritjen e aksesit në ndihmë.

QSHNJP Vlorë në datën 08.04.2025 mori pjesë në aktivitetin “Ndërlidhja e Arsimit dhe Punësimit për Përfshirje Sociale”, organizuar nga Bashkia Vlorë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, ku u diskutua për integrimin arsimor dhe punësimin e komuniteteve rom dhe egjiptian, si dhe u theksua bashkëpunimi ndërinstitucional për ofrimin e shërbimeve sociale dhe juridike.



QSHNJP Vlorë në datën 11.04.2025 ishte e ftuar në trajnimin e organizuar nga Qendra “Vatra” mbi rehabilitimin e autorëve të dhunës dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

QSHNJP Vlorë në datën 15.04.2025 ishte pjesë e serisë së takimeve me temë: “Me ligjin mburojë”, për promovimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

QSHNJP Vlorë në datën 28.04.2025 u vizitua nga përfaqësuesja e UNDP znj. Randi Davis.



QSHNJP Korçë në datën 08.04.2025 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social në Shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, ku u prezantua Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve.

QSHNJP Korçë në datën 11.04.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Bashkia Korçë dhe UN Women, ku u diskutua Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore.


QSHNJP Korçë në datën 15.04.2025 në bashkëpunim me KMD, zhvilloi një takim informues me kategori vulnerabël, ku u prezantua Ligji Nr.111/2017 dhe shërbimet e ndihmës juridike falas që garantohen nga shteti.

QSHNJP Korçë në datën 16.04.2025 zhvilloi një takim informues mbi ndihmën ligjore falas në qytetin e Maliqit me kategori vulnerabël.

QSHNJP Korçë në datën 29.04.2025 mori pjesë në tryezën e organizuar nga ADRF me institucione lokale, ku u diskutua mbi aksesin në drejtësi dhe barazinë para ligjit për personat me aftësi të kufizuara.

QSHNJP Korçë në datën 29.04.2025 realizoi një intervistë me fokus informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas. Intervista u zhvillua në bashkëpunim me Radio Emanuel.





QSHNJP Gjirokastër në datën 10.04.2025 ka zhvilluar një intervistë lidhur me ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” e cila është publikuar nga televizioni Euronews, 6 plus 1 Vlora dhe televizioni kombëtar Top - Channel.

Top Channel/ Ndhimë juridike falas/
Gjirokastër, qendra e ndihmës parësore ka t.

QSHNJP Gjirokastër në datën 11.04.2025 mori pjesë në tryezën e organizuar nga SHDPAK, ANAD dhe Down Syndrome Albania në Gjirokastër, ku u diskutua mbi aksesin në drejtësi dhe barazinë para ligjit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe roli i DNJF në mbështetjen e tyre.



Punonjësi i **QSHNJP Mat**, në datën 22.04.2025 ka dhënë një intervistë mbi ndihmën juridike falas për televizionin lokal MAT-TV.

QSHNJP Mat në datën 09.04.2025 mori pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial në Bashkinë Mat, ku u diskutuan raste të dhunës në marrëdhënie familjare dhe u evidentua roli i QSHNJP Mat në asistimin e këtyre rasteve.

QSHNJP Mat në datën 15.04.2025 zhvilloi në shkollën “Mustafa Gjestila” aktivitetin me fokus prezantimin e shërbimit të ndihmës juridike falas të të miturit.

QSHNJP Mat në datën 22.04.2025 mori pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial në Bashkinë Mat, ku u trajtuan rastet e dhunës në familje dhe u informuan viktimat për shërbimet ligjore të ofruara nga QSHNJP, në kuadër të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.



QSHNJP Tiranë në datën 15.04.2025 ishte pjesë e aktivitetit “Akses në Drejtësi dhe Barazi para Ligjit për Personat me Aftësi të Kufizuara”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, avokatëve, ekspertëve dhe organizatave të PAK, ku u diskutuan sfidat dhe u prezantuan rekomandime për përmirësimin e kushteve ligjore dhe aksesit në drejtësi për këtë grup.

QSHNJP Tiranë në datën 16.04.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi ndihmën juridike falas.



QSHNJP Tiranë në datën 23.04.2024 zhvilloi një takim me përfaqësues dhe aktivistë të komunitetit Rom pranë Qendrës “Gonxhe Bojaxhi”.

Punonjësja e **QSHNJP Tiranë** ishte pjesë e takimeve në Bashkinë e Kamzës dhe Vorës, së bashku me Drejtorinë e Ndhimës Juridike Falas dhe prezencën e OSBE në Shqipëri.



QSHNJP Tropojë, me ftesë të shoqatës “Integrimi”, mori pjesë në një takim u tema kryesore e diskutimit ishin të drejtat e grave. QSHNJP Tropojë prezantoi pjesëmarrësit me Ligjin nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, si dhe ftoi çdo grua me të ardhura të pamjaftueshme apo pjesë e kategorive të veçanta të paraqitet pranë QSHNJP Tropojë në rast nevojë për ndihmë juridike falas.

QSHNJP Kurbin në kuadër të 8 Prillit - Ditës Ndërkombëtare të komunitetit Rom, zhvilloi një takim ndërgjegjëses me anëtarë të këtij komuniteti pranë ambienteve Qendrës për Shërbimin e Ndhmës Juridike Parësore Kurbin. Gjatë takimit u diskutua mbi problematikat ligjore me të cilat ky komunitet përballë dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.



QSHNJP Shkodër, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, ka zhvilluar një takim me disa prej anëtarëve të këtij komuniteti. Takimi synon të informojë individët mbi ndihmën juridike falas dhe mënyrat e përfitimit të saj.



QSHNJP Shkodër ishte e ftuar në aktivitetin e zhvilluar nga ADRF lidhur me aksesin në drejtësi të personave nga kategoritë e veçanta. Në aktivitet u vlerësua kontributi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në dhënien e aksesit falas në drejtësi.



QSHNJP Lushnje në datën 08 Prill, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, mori pjesë në Konferencën Lokale “Me Romët, për Romët”, ku diskutuan mbi fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian, promovimin e qeverisjes së mirë dhe parandalimin e abuzimeve, duke ofruar gjithashtu ndihmën ligjore falas për çdo problem ligjor që mund të kenë anëtarët e këtij komuniteti.

QSHNJP Lushnje në datën 25.04.2025 mori pjesë në një aktivitet mbi dhunën ndaj grave në hapësirën dixhitale, duke theksuar menaxhimin efektiv të rasteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

